



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË
BORDI

VENDIM

Nr. 250, datë 13.12.2021

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 112, DATË 26.04.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 34, DATË 04.02.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 02.11.2007, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 dhe 3 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 151/8 prot., datë 10.12.2021 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes “Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HEREA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar”,”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 112, datë 26.04.2021 vendosi
 1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 34, datë 04.02.2021, sipas kushteve të cituara në këtë vendim, me objekt rishikimi nga ERE pas përfundimit të afatit 3-mujor.
 2. Të shfuqizojë vendimin e bordit të ERE-s nr. 34, datë 04.02.2021.
- Në vijim të kësaj vendimarrje ERE ka njoftuar shoqërinë duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar brenda afateve dokumentacionin e kërkuar në këtë vendim.
- Brenda afatit të vendosur në vendimin nr. 112/2021, shoqëria “HERA” sh.p.k. ka përcjellë argumenta dhe dokumentacion në lidhje me plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Nga shqyrtimi paraprak i këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëria ka referuar se është në proces për t’u pajisur me dokumentacione përkatëse nga organe të tjera të shtetërore, sic janë bashkitë në lidhje me dokumentet e pronësisë apo Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) në lidhje me lejen mjedisore. ERE i dërgoi shkresa këtyre institucioneve për të marrë një informacion të saktë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 219, datë 27.10.2021, vendosi të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e tij në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të bordit nr. 112, datë 26.04.2021.
- Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 79, datë 09.11.2021, në datën 23.11.2021, në ambientet e ERE-s është zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e shoqërisë “HERA” sh.p.k. i cili ka sqaruar/argumentuar mbi dokumentacionin e depozituar dhe plotësimin e kushteve të vendimit të bordit të ERE-s nr. 112/2021.
- *Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.1 të Vendimit nr. 112/2021 që ka të bëjë me kontratat e rinovuara të qirasë me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit, shoqëria bën me dije se ka marrë miratimin për fillimin e procedurave për rilidhjen e kontratave të qirasë së tokës me Bashkinë Pogradec dhe se kjo e fundit ka shprehur interesin për të bashkëpunuar me shoqërinë “HERA” sh.p.k. Shoqëria “HERA” sh.p.k. i është drejtuar bashkive Devoll dhe Maliq me kërkesën për rinovimin/lidhjen e kontratës me objekt dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor subjektivit “HERA” sh.p.k. në kuadër të zhvillimit të parkut eolik KAPPET. Bashkia Maliq ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me shoqërinë “HERA” sh.p.k. pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet. Gjithashtu shoqëria ka deklaruar se këto procedura do të kërkojnë përgatitjen e dokumentacionit topografik në formatin e kërkuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), dokumentacioni i cili nuk posedohet nga bashkitë, për rrjedhojë shoqëria “HERA” sh.p.k., do ta përgatisë këtë dokumentacion me shpenzimet e veta.*
Pavarësisht se ky kusht nuk mund të konsiderohet i plotësuar tërësisht, shoqëria ka dokumentuar, korrespondencat përkatëse me bashkitë për të filluar procedurën për t’u pajisur me dokumentacionin pronësor respektiv në kuadër të plotësimit të kushtit të vendimit nr. 112/2021.
- *Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3.2 të Vendimit nr. 112/2021 që ka të bëjë me Lejen Mjedisore të rinovuar, shoqëria ka dokumentuar në ERE aplikimin e bërë në sistemin online nëpërmjet platformës e-albania, për vlerësimin e ndikimit në mjedis, së bashku me dokumentacionin mbështetës. Ky kusht i vendimit mbetet ende i pa plotësuar, shoqëria rezulton se është në proces për t’u pajisur me Lejen Mjedisore të rinovuar.*

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa “a” të Vendimit nr. 112/2021 që ka të bëjë me miratimin e plotë nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, shoqëria bën me dije se po vijon me përgatitjen e raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor të zonës, me pëfudimin e të cilit do të aplikojë në sistemin e-albania dhe më tej do të jetë në pritje të vendimarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) pranë Minsitrisë së Kulturës.
Ky kusht mbetet ende i pa plotësuar pasi për të marrë miratimin e KKTKM, nevojitet më parë kryerja e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor, të cilin shoqëria deklaron se e ka në proces.
- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, germa “b” të Vendimit nr. 112/2021 që ka të bëjë me dokumentacionin ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik shoqëria “HERA” sh.p.k. ka depozituar në ERE pasqyrat financiare vjetore të përgatitura nga ekspertët kontabël dhe investimet e kryera nga vetë ajo në harkun kohor 2007 - 2021. Në lidhje me këtë kusht, rezulton që shoqëria ka depozituar dokumentacion në ERE, që vërteton kryerjen e investimeve në kuadër të zhvillimit të projektit eolik deri në momentin e depozimit të këtij dokumentacioni në ERE. Në vijim shoqërisë vlerësohet t’i lihet ende ky kusht në kuadër të dokumentimit të investimeve që do të kryejë deri në plotësimin e të gjitha kushteve dhe finalizimin e projektit.
- Në lidhje me shkresën e dërguar nga shoqëria në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), konstatohet se ajo ka përcjellë matjet e kryera me qëllim marrjen e një mendimi në lidhje me nivelin e standardeve të pritshmërisë së kërkuar për zhvillimin e këtyre projekteve dhe se shoqëria ka shprehur angazhimin e saj për të vijuar me plotësimin e kushteve respektive të vendosura nga ERE.
- Në përfundim shoqëria “HERA” sh.p.k. ka kërkuar nga ERE shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 112/2021, për të paktën 9 muaj, duke u angazhuar që të vendosë në dijeni ERE-n për çdo korrespondencë dhe zhvillim të proceseve në përmbushjen e kushteve dhe të kërkesave të saj.
- Për gjithë sa më sipër, referuar përpjekjeve të shoqërisë në kuadër të plotësimit të kushteve dhe kërkesës së saj për shtyrje, bazuar edhe në përgjigjet që vetë ERE ka marrë nga organet e tjera, vlerësohet se afati prej 9 muajsh për plotësimin e secilit prej kushteve të vendimit nr. 112/2021, është i arsyetuar dhe duhet të merret në konsideratë.
- Shoqërisë “HERA” sh.p.k. t’i lihet detyrimi që të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.
- ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë në përputhje me përditësimin e plotësimit të kushteve nga shoqëria, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.1, 3.3 dhe pikën 4, gërma “a” dhe “b” (Leja e Mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës vërtetues për realizimin e investimeve), të Vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, nga shoqëria “HERA” sh.p.k.
2. Shoqëria “HERA” sh.p.k. të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.
3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet kompetente.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë kërkuuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 250, datë 13.12.2021

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 112, DATË 26.04.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 34, DATË 04.02.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 02.11.2007, I NDRYSHUAR”

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Erjola Sadushi

Maksim Shuli

Raimonda Islamaj
